

Kryetarja e Komisionit për Ekonominë dhe Financat Znj. Milva Ekonomi prezanton në Autoritet, Drejtorin e Përgjithshëm Ekzekutiv Z. Ervin Mete

Vështrim mbi tregjet

Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri për periudhën janar-maj 2020

Zhvillime të tjera

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv, Z. Ervin Mete gjatë muajit qershor zhvilloi takime me drejtues të institucioneve të vendit dhe të huaja, si edhe me drejtues të shoqërive që veprojnë në tregjet financiare nën mbikëqyrje

Edukimi i Konsumatorit

“Të kuptuarit e vlerave të qëndrueshmërisë dhe teknologjisë: Sistemi financiar botëror pas Covid-19” – (pjesa e dytë)

Botime Profesionale

Global Risk Regulator Financial Times

Lajme Ndërkombëtare

Evropa Qendrore dhe Juglindore Greqi Serbi Turqi

Mbrojmë Konsumatorët - Promovojmë Tregjet - Zbatojmë Ligjin

Kryetarja e Komisionit për Ekonominë dhe Financat të Kuvendit të Shqipërisë, Znj. Milva Ekonomi prezanton në Autoritet, Drejtorin e Përgjithshëm Ekzekutiv të AMF-së Z. Ervin Mete



1 qershor 2020 – Prezantohet në Autoritet Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv

Z. Mete theksoi se digjitalizimi, mbetet fokusi kryesor, si në aspektin e raportimit në kohë reale nga ana e subjekteve nën mbikëqyrje, ashtu edhe në komunikimin ndërinstytucional.

Kryetarja e Komisionit për Ekonominë dhe Financat e Kuvendit të Shqipërisë, Znj. Milva Ekonomi, prezantoi në Autoritet, në datë 1 qershor, Drejtorin e Përgjithshëm Ekzekutiv Z. Ervin Mete. Znj. Ekonomi uroi Drejtorin e Përgjithshëm Ekzekutiv për detyrën dhe theksoi se Autoriteti ka përpara një volum të madh pune, ndër të tjera, edhe për plotësimin e kuadrit rregullator pas miratimit të ligjeve të reja të miratuara së fundmi nga Kuvendi. Znj. Ekonomi shprehu gatishmërinë për një bashkëpunim të ngushtë mes Komisionit dhe Autoritetit në kuadër të ndryshimeve të reja ligjore dhe monitorimit të punës së institucionit.

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv paraqiti vizionin dhe objektivat kryesore të mandatit të tij në drejtim të Autoritetit. Ndër të tjera Z. Mete theksoi se në përgjithësi tregjet nën mbikëqyrjen e AMF-së i rezistuan efekteve të pandemisë, por e gjithë situata solli nevojën e disa ndryshimeve nga ana e Autoritetit. Digjitalizimi, mbetet fokusi kryesor, si në aspektin e raportimit në kohë reale nga ana e subjekteve nën mbikëqyrje, ashtu edhe në komunikimin ndërinstytucional.

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv nënvizoi rëndësinë e një strategjie për menaxhimin e krizave, në kuadër afatmesëm nga Autoriteti. Z. Mete theksoi se edhe subjektet nën mbikëqyrje duhet të disponojnë planet e nevojshme për vazhdimësinë e biznesit edhe përgjatë situatave të jashtëzakonshme, siç ishte ajo e shkaktuar nga pandemia COVID-19.

<https://amf.gov.al/news.asp?id=32499>

VËSHTRIM MBI TREGJET

Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri, janar-maj 2020


Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimit për periudhën janar-maj 2020 kapën vlerën mbi 6,068 milionë lekë, ose 9.99% më pak se në periudhën janar-maj 2019. Gjatë periudhës janar-maj 2020, numri i kontratave të sigurimit të lidhura arriti në 354,651 me një ulje prej 26.53% krahasuar me periudhën janar-maj 2019.

Tregu vazhdoi të mbetet sërish i orientuar tek sigurimet e Jo-Jetës, të cilat sollën 93.31% të vëllimit të përgjithshëm të primeve, duke i lënë përkatësisht sigurimet e Jetës me 6.69%. Parë nga këndvështrimi i ndarjes së tregut sipas llojit të sigurimit, i detyrueshëm dhe vullnetar, primet e shkruara bruto të sigurimit vullnetar zënë 41.41% dhe primet e shkruara bruto të sigurimit të detyrueshëm zënë 58.59% të totalit të tregut.

Gjatë periudhës janar-maj 2020, dëmet e paguara bruto në tregun e sigurimeve, arritën në rreth 3,417 milionë lekë, ose 45.88% më shumë se në periudhën janar-maj 2019.

— ○○○ —
Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimit për periudhën janar - maj 2020 kapën vlerën mbi 6,068 milionë lekë.
— ○○○ —

Struktura e tregut të sigurimeve, janar-maj 2020 (Në %)




ZHVILLIME TË TJERA

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv zhvilloi gjatë muajit qershor takime me drejtues të institucioneve të vendit dhe të huaja



5 qershor 2020 - Takim me Guvernatorin e Bankës së Shqipërisë

Në takimin me Guvernatorin e Bankës së Shqipërisë, Z. Gent Sejko, u diskutua kryesisht për situatën në tregjet financiare nën mbikëqyrje dhe efektet e COVID-19. Guvernatori i Bankës së Shqipërisë dhe Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së biseduan mbi forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe finalizimin e Marrëveshjes së Mbikëqyrjes së Konsoliduar mes dy institucioneve. Bashkëpunimi do të shtrihet edhe në kuadër të Grupit Këshillimor të Stabilitetit Financiar dhe krijimin e komiteteve të përbashkëta për zhvillimin e tregjeve. <https://amf.gov.al/news.asp?id=32503>



11 qershor 2020 - Takim në platformat online me menaxheren e Bankës Botërore për Shqipërinë, znj. Maryam Salim

Bashkëpunimi me Bankën e Shqipërisë do të shtrihet edhe në kuadër të Grupit Këshillimor të Stabilitetit Financiar dhe krijimin e komiteteve të përbashkëta për zhvillimin e tregjeve.

Në takim, theksi u vendos në projektin e ri të asistencës të Bankës Botërore për tregjet e kapitalit dhe tregun e sigurimeve, si edhe gatishmërinë për të vijuar asistencën ndaj AMF-së.

Në takimin *online* të datës 11 qershor me Menaxheren e Bankës Botërore për Shqipërinë, Znj. Maryam Salim, theksi u vendos në projektin e ri të asistencës të Bankës Botërore për tregjet e kapitalit dhe tregun e sigurimeve, si edhe gatishmërinë për të vijuar asistencën ndaj AMF-së. Projekti aktual ka një fond me vlerë 1.59 milionë dollarë, me donator Sekretariatit Shtetëror Zviceran për Çështjet Ekonomike (SECO). Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv e falënderoi për mbështetjen e vazhdueshme të Autoritetit.

...

... Projekti, në komponentin e tregut të kapitalit do të shërbejë për përgatitjen e rregulloreve dhe udhëzimeve përkatëse bazuar në dy ligjet e miratuara së fundmi në Kuvend. Ndërsa për tregun e sigurimeve, projekti synon mbështetjen e AMF-së për realizimin e mbikëqyrjes me bazë rreziku dhe përgatitjen për kuadrin evropian të *Solvency II*, si edhe rritjen e besimit të konsumatorit në sigurime, duke përdorur transparencën dhe llogaridhënien e shoqërive të sigurimit. <https://amf.gov.al/news.asp?id=32507>



12 qershor 2020 - Takim me Kryetaren e Autoritetit të Konkurrencës

Në datë 12 qershor, Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv, z. Ervin Mete, zhvilloi një takim pune me Kryetaren e Autoritetit të Konkurrencës, znj. Juliana Latifi. Bashkëpunimi institucional, në funksion të mirërregullimit të tregjeve, mbrojtjes së konsumatorit dhe mbështetja reciproke në funksion të mbrojtjes së konkurrencës së lirë dhe efektive në treg ishin çështjet kryesore të diskutimit. <https://amf.gov.al/news.asp?id=32510>



25 qershor 2020 – Takim online me Guvernatorin e Bankës Qendrore të Kosovës

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, z. Ervin Mete zhvilloi më 25 qershor një takim *online* me Guvernatorin e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, z. Fehmi Mehmeti. Në takim u diskutua mbi forcimin e bashkëpunimit institucional, për mbikëqyrje efektive të tregjeve, sidomos për ecurinë e mëtejshme të punës në Kolegjet Mbikëqyrëse Rajonale për grupet e sigurimit që ushtrojnë veprimtari në të dy shtetet. Guvernatori i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës dhe Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së diskutuan edhe për çështje lidhur me policat ndërkuftare, trajtimin dhe pagesat e dëmeve, zhvillime në fushën legjislative të sigurimeve, etj.



Bashkëpunimi institucional, në funksion të mirërregullimit të tregjeve, mbrojtjes së konsumatorit dhe mbështetja reciproke në funksion të mbrojtjes së konkurrencës së lirë dhe efektive në treg ishin çështjet kryesore të diskutimit.



Në takim u diskutua mbi forcimin e bashkëpunimit institucional, për mbikëqyrje efektive të tregjeve.



Takime të Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv me drejtues të shoqërive që veprojnë në tregjet nën mbikëqyrje



9 qershor 2020 - Takim me drejtuesit e shoqërive të sigurimit

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, Z. Ervin Mete, zhvilloi gjatë muajit qershor, takime pune me drejtuesit e shoqërive të sigurimit, drejtues të shoqërive administruese të fondeve të investimit, pensioneve private vullnetare dhe përfaqësues të tregut të kapitaleve, si dhe me drejtues të lartë të bankave.

Në takimin me drejtuesit e shoqërive nën mbikëqyrje u diskutua mbi ecurinë e tregjeve, në veçanti për efektet e pandemisë COVID-19 dhe mundësitë për zhvillimin e mëtejshëm të tyre.

Me drejtues të shoqërive në tregun e sigurimeve u diskutua ndër të tjera mbi procesin e dëmshpërblimit pas dy tërmeteve të vitit të kaluar. Z. Mete vlerësoi menaxhimin e situatës pas tërmetit nga ana e shoqërive të sigurimit, si edhe ecurinë e procesit të dëmshpërblimit, ndërsa kërkoi përmbylljen pa vonesa të të gjithë pagesave të mbetura pezull. Po ashtu u diskutua për të rishikuar planet e vazhdimësisë së biznesit në rastet e krizave dhe situatave të jashtëzakonshme. <https://amf.gov.al/news.asp?id=32504>



18 qershor 2020 - Takim me drejtues të shoqërive administruese të fondeve të investimit, pensioneve private vullnetare dhe përfaqësues të tregut të kapitaleve



Në takimin me drejtuesit e shoqërive nën mbikëqyrje u diskutua mbi ecurinë e tregjeve, në veçanti për efektet e pandemisë COVID-19 dhe mundësitë për zhvillimin e mëtejshëm të tyre.



Në takimin Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv theksoi rëndësinë e hartimit të një strategjie kombëtare për zhvillimin e tregjeve të kapitalit në vend.

Në takimin me drejtues të shoqërive administruese të fondeve të investimit, pensioneve private vullnetare dhe përfaqësues të tregut të kapitaleve Z. Mete vuri në dukje se situata e pandemisë, e menaxhuar mirë nga tregu, nxori në pah nevojën për plane solide të vazhdimësisë së biznesit. Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv theksoi rëndësinë e hartimit të një strategjie kombëtare për zhvillimin e tregjeve të kapitalit në vend, me pjesëmarrjen e Ministrisë së Financave, Bankës së Shqipërisë apo aktorëve të tjerë, si edhe gatishmërinë për t'u përfshirë në një proces konsultues me aktorët e tregut në funksion të hartimit të akteve nënligjore për plotësimin e kuadrit ligjor për sipërmarrjet e investimeve kolektive dhe tregjet e kapitalit. <https://amf.gov.al/news.asp?id=32515>

Në takimin me drejtuesit e lartë të bankave u diskutua në lidhje me çështjet që kanë të bëjnë me ligjet e reja të miratuara së fundmi në Kuvend "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive" dhe "Për tregjet e kapitalit". Po ashtu u diskutua mbi thellimin e bashkëpunimit me Shoqatën e Bankave në drejtim të edukimit financiar të publikut.

EDUKIMI I KONSUMATORIT

“Të kuptuarit e vlerave të qëndrueshmërisë dhe teknologjisë: sistemi financiar botëror pas Covid-19”

Learning the value of resilience and technology: the global financial system after Covid-19.

Diskutimi i Benoît Cœuré, Drejtues i Qendrës së Inovacionit, Bank for International Settlements, mbajtur në 17 prill 2020 në konferencën në webinar me temë "Ekonomia botërore u shndërrua". Në fjalën e tij Benoît Cœuré thekson se mbetet ende për tu parë, se si do të shpaloset kriza pas Covid-19, as kur do të përfundojë ajo. Ai thekson se valët e tronditjes që dërgon kjo krizë në ekonominë botërore sapo kanë filluar të ndjehen në ekonominë në zhvillim - dhe ato do të na kthehen. Në diskutim sugjerohen dy tema që formësojnë "ditët pas Covid-19": qëndrueshmëri dhe teknologji.

Marrë me shkurtime dhe redaktime - (pjesa e dytë dhe e fundit)

Vlera e teknologjisë

Kriza ka nxjerrë në pah vlerën e teknologjisë që i mundësojnë ekonomisë të funksionojë duke ruajtur distancimin social dhe duke kapërcyer problematikat e krijuara pikërisht nga distanca sociale. Ndryshime të tilla, kaq të mëdha në modelet e punës dhe ato të konsumit, siç është kalimi thuajse tërësor drejt blerjeve *online*, do të ketë një ndikim të qëndrueshëm në marrëdhëniet ekonomike.

E para tek e cila na shkon mendja është industria e pagesave. Pagesat kanë qenë në pararojë të ndryshimit teknologjik, këto kohë. Një zhvendosje e shpejtë drejt pagesave digjitale përmirëson koston, transparencën dhe komoditetin për shumë konsumatorë. Bashkëpunimi ndërkombëtar është i nevojshëm për të mbështetur kapacitetet teknologjike në ekonominë në zhvillim, për të siguruar ndërveprimin midis sistemeve kombëtare, për të rritur pagesa ndërkufitare dhe dërgesat dhe për të mbështetur përfshirjen financiare pra, për të shmangur copëzimin hapësinor dhe shoqëror.

Plani i veprimit i Bordit të Stabilitetit Financiar (FSB) dhe i Komisionit për Pagesa dhe Infrastrukturave të Tregut (CPMI) lidhur me pagesat ndërkufitare, i cili u publikua në mes të muajit prill, vjen tamam në kohën e duhur. Po kështu mjaft i rëndësishëm ishte edhe raporti konsultativ i FSB për implikimet rregullatore të *stablecoins*.*)

Edhe në bankat qendrore, diskutimet aktuale për monedhën digjitale janë sjellë gjithnjë e më tepër në fokus. Nëse situata e Covid-19 do të përshpejtojë shmangien e parave fizike në duar, kjo është ende një pyetje e hapur. Por tashmë, kjo situatë theksoi vlerën e qasjes te mjetet e tjera të pagesës, dhe nevojën që çdo mjet pagese të jetë elastik ndaj një game të gjerë kërcënimesh.

*) *Stablecoin* është një lloj i ri i kriptomonedhave, të cilat synojnë të ofrojnë stabilitet të çmimeve dhe janë të mbështetura nga *reserve asset*, (asetet e vlerësuara në monedhë të huaj që mbahen nga banka qendrore dhe përdoren kryesisht për të balancuar pagesat).

Një zhvendosje e shpejtë drejt pagesave digjitale mund të përmirësojë koston, transparencën dhe komoditetin për miliarda konsumatorë.

Situata me Covid-19 do të përshpejtojë kalimin drejt digjitalizimit edhe përtej pagesave. A do ta gjejnë klientët rrugën e tyre drejt degëve bankare kur të hiqen kufizimet e lëvizjeve dhe ekonomitë të rifillojnë? A do ta përshpejtojë kjo lëvizjen drejt bankingut virtual? Në muajt dhe vitet e ardhshme, Qendra e Inovacionit BIS do të jetë e ngarkuar me skanimin e tendencave teknologjike në financa dhe pasojat e tyre për bankat qendrore dhe rregullatorët financiarë, bazuar në projekte praktike. Çështje të tilla si përdorimi i gjerë i *token*, hapja e bankave dhe përdorimi i teknologjisë për të mbështetur përputhshmërinë me funksionet rregulatore dhe mbikëqyrëse ("*regtech*" dhe "*suptech*") janë në qendër të axhendës sonë.

Duke ju kthyer edhe një herë pikës së nxehtë të diskutimit tonë, dëshiroj të theksoj se teknologjia mund të ndihmojë në zbutjen e ndikimit ekonomik dhe shoqëror të krizës Covid-19.

Debati po shtrihet që nga mënyra se si teknologjia mund të ndihmojë në gjurmimin e përhapjes së virusit, zbatimin e karantinës dhe administrimin e këshillimeve të largëta, e deri tek ajo se cilat janë masat e nevojshme për të mbrojtur privatësinë. Teknologjia gjithashtu mund të ndihmojë në zbutjen e kostos ekonomike të mbylljeve e izolimeve dhe të shmangë dëmtimet e pakthyeshme në strukturën sociale. Grupet sociale të popullsisë, më të prekshme në shoqëritë tona, ka më pak të ngjarë të arrihen nga masat tradicionale të mbështetjes. Kjo është veçanërisht më e dukshme në rastet e ekonomive ku infrastruktura e taksave direkte është më pak e zhvilluar dhe ekonomia informale është e përhapur. Pagesat digjitale mund t'u japin mundësi qeverive të ofrojnë mbështetje urgjente për familjet dhe bizneset e vogla të prekura nga virusi. Ato mund të ndihmojnë të pompojnë fondet e shpëtimit në pikat më fundore të ciklit të shpërndarjes.

Institucionet rregulatore në vendet në të cilat janë krijuar sisteme të pagesave me pakicë dhe rrugë për identifikimin, po i shfrytëzojnë ato për të përmirësuar reagimin e tyre ndaj krizës. Siç është vënë në dukje nga Banka Botërore, llogaritë bankare të lidhura me numrat/kartat e identitetit/ID p.sh. në Kili, do të lejojnë 2 milionë kilianë, nga grupet vulnerable të popullsisë, të përfitojnë nga mbështetja e lidhur me Covid që prej këtij muaji. Koordinimi ndërkombëtar është thelbësor, për shembull, për të mbajtur rrjedhshmërinë e dërgesave nga jashtë.

Për ato institucione rregulatore dhe vende që nuk kanë krijuar infrastrukturë digjitale, nuk është vonë për ta bërë këtë. Udhëzimet e fundit nga CPMI dhe Banka Botërore i ndihmojnë ata të hartojnë strategjitë e duhura për të çuar përpara përfshirjen financiare përmes inovacionit në sistemet e pagesave. Nxjerrja e mësimave të duhura nga kjo krizë nuk është e mjaftueshme – është koha për të vepruar.

Pagesat digjitale mund t'u japin mundësi qeverive të ofrojnë mbështetje urgjente për familjet dhe bizneset e vogla të prekura nga virusi.

Global Risk Regulator



Autoriteti Francez i Mbikëqyrjes Financiare percepton ende çështje të lidhura me transparencën në tregun e letrave me vlerë të korporatave në Francë. (*Autorité des Marchés Financiers (AMF) still sees transparency issues in French corporate bond market*)

Në një vlerësim të transparencës së tregut të bonove përgjatë dy viteve, pas hyrjes në fuqi direktivës MiFID II, rregullatori francez i letrave me vlerë, (*Autorité des Marchés Financiers*) zbuloi se ka ende shumë boshllëqe në të dhënat e nevojshme për të pasur një pasqyrim të plotë të veprimtarisë së tregut.

<https://www.globalriskregulator.com/Subjects/Reporting-and-Governance/AMF-still-sees-transparency-issues-in-French-corporate-bond-market>

Financial Times

Siguruesit përballë biznesit të vogël: Një betejë e fuqishme mbi efektet e mbylljes në kohën e pandemisë. (*Insurers vs small businesses: a high-stakes battle over lockdowns.*)

Autor: Oliver Ralph, Robert Armstrong

<https://www.ft.com/content/a2bdd16b-05b7-4358-8101-185bfbcf62e2>

Siguruesit planifikojnë të përfshijnë pandemitë në skemën e sigurimeve ndaj terrorizmit, në Mbretërinë e Bashkuar (*Insurers plan to include pandemics in UK terror scheme*)

Autor: Oliver Ralph

Kompania "Pool Re", që ka edhe mbështetjen e qeverisë në Britaninë e Madhe po planifikon të zgjerojë veprimtarinë për të mbuluar edhe raste të tilla si të pandemisë.

<https://www.ft.com/content/ba7246aa-61db-44d7-b729-7a43271a7010>



Evropa Qendrore dhe Juglindore www.xprimm.com

Stuhitë e forta ditore të shiut që përshkuan Evropën Qendrore dhe Juglindore, në dy javët e fundit të muajit qershor 2020, shkaktuan përmbytje në vende si Hungaria, Republika Çeke, rajone të Polonisë, Rumanisë edhe Turqisë, duke shënuar humbje të mëdha.

Në Budapest moti i keq vazhdoi edhe për disa ditë. Siguruesit hungarezë vlerësojnë se humbjet e shkaktuara nga stuhitë e ditëve të fundit mund të arrijnë në 4.3 milionë euro. Sipas disa kompanive që kanë pranuar mijëra dosje kërkesash për dëmshpërblime, duke pasur parasysh ashpërsinë e madhe të motit, si dhe karakteristikat e zonave të banuara në të cilat goditen, vlera mesatare e kërkesave mund të jetë dukshëm më e lartë se ajo e zakonshme për stuhitë e verës (deri në 580 euro që është 2.5 - 4 herë humbje më e lartë se mesatarja e zakonshme).

Zona të ndryshme të Republikës Çeke u goditën sërish nga stuhitë dhe përmbytjet në javën e dytë të qershorit. Ky ishte incidenti i dytë i përmbytjeve në vend. Kërkesat për dëmshpërblime priten të rriten mjaft, pasi vetëm pas stuhisë së parë të fillimit të qershorit, një kompani mori mbi 940 kërkesa, me vlerë 2.9 milionë euro, ndërsa pas episodit të dytë priten rreth 1.200 kërkesa me vlerë përafërsisht 2 milionë euro. Edhe shoqëritë e tjera të sigurimeve kanë regjistruar dëme me dhjetëra milionë Korona Çeke.

Përmbytja goditi qarkun Kestel të provincës së Bursës, në Turqi, më 21 qershor. Pas vlerësimeve fillestare, qeveria e provincës raportoi edhe për humbje të jetëve njerëzore. Ndërkohë sipas zyrtarëve turq, u prekën pesë rajone, 43 fshatra dhe dhjetëra mijëra hektarë tokë bujqësore.

Greqi www.xprimm.com

Presidenti i departamentit për automjetet pranë Shoqatës së Kompanive Greke të Sigurimeve, Dimitris Zorbas, deklaroi se numri i automjeteve të pasiguruara në Greqi është rreth 586,000. Shifrat i referohen të dhënave statistikore për vitin 2018-2020, sikurse njoftohet nga National Herald. Z. Zorbas citohet të ketë thënë se "... Çështja e automjeteve të pasiguruara është një çështje sociale dhe ekonomike që duhet të zgjidhet një herë e përgjithmonë". Ai shtoi se propozohet që kontrolli të bëhet në mënyrë elektronike, dhe nëse dikush zbulohet se është i pasiguar, të vendosen menjëherë gjobat e përcaktuara nga legjislacioni, sikurse veprojnë shumica e vendeve evropiane."

Sipas të dhënave të siguruar nga Autoriteti Statistikor Hellenic, në vitin 2019, në rrugët e Greqisë kishte në përdorim 5.4 milionë makina private pasagjerësh dhe afër 1.4 milionë automjete tregtare (kamionë dhe autobusë), që do të thotë që automjetet e pasiguruara zënë rreth 7% të flotës kombëtare.

Serbi

www.xprimm.com

Sekretari i Përgjithshëm i Shoqatës së Siguruesve të Serbisë, Dusko Jovanovic, i cituar nga platforma *online* osiguranje.hr shpreh se vetëm 2 ose 3% e familjeve në Serbi janë të siguruar nga përmbytjet, dhe se sigurimi i pasurisë është bërë nga më pak se 10% e familjeve.

Sigurimi i shtëpive dhe sigurimi në bujqësi u sollën sërish në vëmendje nga përmbytjet që prekën Serbinë, si edhe rajone të tjera të zgjeruara në Evropën Qendrore dhe Lindore. Shiu i madh dhe përmbytja në Serbi dhe Bosnje i detyruan autoritetet të shpallnin në fund të qershorit një gjendje të jashtëzakonshme në disa bashki, pasi lumenjtë e fryrë dëmtuan urat, rrugët dhe linjat e energjisë. Sipas televizionit publik, RTS, që nga 23 qershori, rreth 700 shtëpi janë përmbytur në Serbinë perëndimore dhe qendrore ndërkohë që u prekën edhe toka të mëdha bujqësore. Raportohet se "... janë përmbytur rreth 2,000-3,000 hektarë patate, misër, kopshte perimesh dhe livadhe të përdorura për të ushqyer bagëtitë".

Sipas Shoqatës së Siguruesve të Serbisë, vetëm rreth 25-30% e policave të sigurimeve në Serbi kanë sigurime shtesë nga përmbytja. Në sigurimet në bujqësi, situata është disi më e mirë falë subvencioneve shtetërore për blerjen e sigurimeve. Subvencioni shtetëror zë 40% të vlerës, ndërsa për pesë rrethet me ekspozim të lartë ndaj ngjarjeve të rënda të motit, subvencioni arrin në 75% të vlerës.

Të dhënat statistikore të XPRIMM, evidentojnë se sigurimi i pasurisë në vitin 2019 zinte 18.72% të primeve të shkruara bruto. Klasa e sigurimit nga zjarri, përfshirë sigurimin e shtëpive dhe mbulimin e rreziqeve nga katastrofat natyrore Nat-Cat, zinte 5.6% në totalin e primeve të shkruara bruto, duke arritur në vlerë 51.5 milionë euro.

Turqi

www.xprimm.com

Turqia ka njoftuar se do të mbulojë koston e trajtimit mjekësor për pushuesit, si një masë e përfshirë në Programin e saj të Certifikimit të Turizmit të Sigurt, e cila synon të inkurajojë udhëtarët e huaj të vizitojnë vendin.

Programi i Certifikimit të Turizmit të Sigurt është një sistem zyrtar i akreditimit që duke filluar nga 1 korriku do të certifikojë ofruesit e ndryshëm të shërbimeve të udhëtimit (akomodimi, ofruesit e shërbimeve të transportit, restorante, kafene, bare, etj.) po ofrojnë ambient i sigurt ndaj Covid -19. Duke audituar ambientet e akomodimit dhe ushqimit, në përputhje me kriteret ndërkombëtare, kompanitë e akreditimit që janë të autorizuar të japin Certifikatën e Turizmit të Sigurt do të kryejnë auditime higjienike, shëndetësore dhe do të bëjnë vlerësime të konformitetit, do të përgatisin raporte në lidhje me to dhe do të inspektojnë rregullisht objektet e aplikantëve, nëse ato ofrojnë shërbime sipas kriterëve.

Programi mbulon të gjitha aspektet e udhëtimit, nga fluturimet, aeroportet, deri te transfertat, hotelet dhe restorantet. Që nga 1 korriku, linjat ajrore, operatorët turistikë edhe blerjet *online* do të shesin paketat e sigurimeve që mbulojnë koston mjekësore deri në 7,000 euro, të cilat do të blihen nga udhëtarët me vlera të ndryshme si 15 euro, 19 euro dhe paketat e sigurimeve 23 euro. Shqipëria është një ndër rreth 50 vendet ku mund të sigurohet ky shërbim.



AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

Për informacion të mëtejshëm
ju lutemi na kontaktoni:

Rr. "Dora D'Istria", Nr. 10 , P.O.Box 8363, Tiranë
Tel: +355 42 251 355/6 | Fax: +355 42 250 686
amf@amf.gov.al | www.amf.gov.al